29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me

të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.

- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**



34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Paga pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për stë gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEQANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

K.P.K.		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK.
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	<b>2.1</b>	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
Gjuha	<b>2.2</b>	<i>Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE].</i>
Siguria e ekzekutimit	<b>2.3</b>	<u>Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% të vlerës së kontratës në vlerë prej: <b>7,122.80 EUR.</b></u>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	<b>2.4</b>	<p><i>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</i></p> <p>(a) <i>Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [N/A];</i></p> <p>(b) <i>humbje ose dëmtim i Pajisjeve [N/A];</i></p> <p>(c) <i>humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [N/A];</i></p> <p>(d) <i>dëmtim personal ose vdekje:</i></p> <p><i>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit:[N/A]</i></p> <p><i>(ii) të personave të tjerë: [N/A]</i></p>
Programi	<b>2.5</b>	<u>Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.</u>
Azhurnimi-Periudha e Intervenimit	<b>2.6</b>	<u>Periudha për Programin e azhurnuar është [1] ditë ose 24 orë pas marrjes së shkresës ose një kërkesë nga ana e AK do të jetë efektiv për intervenim për gabimet ose defektet gjatë kryerjes së punëve.</u>
Fillimi i punëve	<b>2.7</b>	Data e fillimit do të jetë <b>[13/06/2022]</b> .
Përfundimi i punëve	<b>2.8</b>	<u>Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 1 vite [12 muaj ] ose 07/06/2023.</u>
Dëmet e likuiduara	<b>2.9</b>	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.05% ] për ditë.Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës.
Inspektimi dhe testimi	<b>2.10</b>	<i>Menaxheri i Projektit është:.....[@rks-gov.net]</i>
Qmimi dhe mënyra e Pagesës	<b>2.11</b>	<p>Çmimi total i punëve do të jetë:</p> <p><b>[71,228.04 € EUR] € [Shtatëdhjetë e njëmijë e dyqindë njëzetë e tetë euro e 04/100] €.</b></p> <p>Çmimi i përmendur në Nenin 2.1,2.2 dhe 2.3 te Anexet Speciale dhe Anexet</p>

		<p>e ndërlidhura më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. Pagesat do të bëhen brenda periudhës së validitetit të kontratës nga pjesa e mjeteve të alokuara në Grandi në Buxhetin e Komunës së Mitrovicës.</p> <p><b>Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës sipas situacioneve të punëve e kryera të aprovuara nga Organi Mbikëqyrës dhe Menaxheri i Projektit.</b></p>
Parapagimi (Avansi)	<b>2.12</b>	<u>N/A nga A.K.</u>
Shkaqet për kompensim	<b>2.13</b>	<i>Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>[5] ditë</b> pas nënshkrimit të kontratës.</i>
Përgjegjësia mbi Defektet	<b>2.14</b>	Periudha garantuese e defekteve është <b>12 muaj [365] ditë nga pranimi teknik i punëve.</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	<b>2.15</b>	<i>Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha punët ose të realizojë punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me <u>[0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së Punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.</u></i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	<b>2.16</b>	<i>Qdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të punëve të kësaj kontrate është e mundur të zgjidhet në mënyr miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit <u>Kontraktues–Komuna Mitrovicës dhe personat përgjegjës të kontraktorit.</u></i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	<b>2.17</b>	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</p>

**PARAMASA - Ndërtimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuarëve në qytet**

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E REGULIMIT TË RRUGËS DIAKONIA**

Nr.	Pershkrimi i punës	Njesia	Sasia	Cmimi Njesi pa TVSH	Cmimi Njesi TVSH	Cmimi Njesi me TVSH	Totali
<b>PUNËT PËRGADITTORE</b>							
1	Inqizimi gjeodezic para fillimit të punimeve, gjatë ekszekutimit të punëve si dhe pas përfundimit të punëve, ku të gjitha sasitë duhet të vërtetohen me matje gjeodezike, sipas kërkesës së organit mbikëqyrës.	m'	100.00	8.47	1.53	0.10	10.00 €
2	Shqyrtimi i të gjitha instalimeve nemoteksonore me mjete adekuate; për të mos bërë dendime në instalime të elektrikes, kabllovikut, internetit, ujësjellësit, kanalizimit dhe të tjera (në rast të dendimit, OIE është i obliguar në hartime të tij të riparoi ato)	m'	100.00	8.47	1.53	0.10	10.00 €
3	Shqyrtimi i të gjitha provave (atestet) për të gjitha shtrësat e rruges, në laborator sipas kërkesës së investitorit (Nerhazes, shtrësat stabilizuese; Tampon 0-63; Tamponi 0-30; kubezave të betonit etj..)	copë	3.00	50.85	9.15	20.00	60.00 €
<b>TOTALI PUNËT PËRGADITTORE:</b>							<b>80.00 €</b>
<b>PUNËT E DHEUT</b>							
1	Gërmimi i dhout i kategorisë së II-VI-te me ngarkim dhe bartje deri në depomi në largësi min. 10km. Në veçim është përfshirë edhe punimi dhe formësimi i kanalëve kulluese të rrugës.	m <sup>3</sup>	195.00	165.25	29.75	1.00	195.00 €
2	Rrafshimi i nënhozës me ngjeshje me vibroçilinder deri në 30 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	650.00	165.25	29.75	0.30	195.00 €
<b>TOTALI PUNËT E DHEUT:</b>							<b>390.00 €</b>



<b>OBJEKTET</b>							
1	Ngritja e puselave me beton të armuar duke bërë shtyllon unik për çdo pusëtë dhe ngritja e pusëtës duhet të bëhet në mënyrë precize dhe të jetë në nivelin me katëzën.	copë	4.00	67.80	12.20	20.00	80.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të Pusëtës duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i grzës mbi 45T on.	copë	4.00	271.19	48.81	80.00	320.00 €
3	Punimi i puselave të reja, përfshirë furnizimin me gypa të betonit Ø800mm së bashku me konus, si dhe kapakun e materiali grzë me peshë bartëse mbi 45T on.	copë	1.00	84.75	15.25	100.00	100.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të ujëmbledhësit (gritave) me dimensione 40x40 cm, i cili duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i grzës mbi 45T on, përfshirë gypin për pusëtë dhe gypin deri te pusca e kanalizimit atmosferik ekzistues.	copë	2.00	101.69	18.31	60.00	120.00 €
<b>TOTALI OBJEKTET:</b>							<b>620.00 €</b>
<b>MBISTRUKTURA</b>							
1	Demolimi i skajoreve ekzistues për kyqe në rrugë, me ngarkim dhe transport të skajoreve të demoluar deri në depot të përcaktuar nga organi mbikqytës.	m <sup>3</sup>	7.00	5.95	1.07	1.00	7.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe shtrija e zhavorit (fraksion Ø-60mm) duke e bërë shtrijen dhe planifikim e tij sipas nivelitës së kërkuar deri në moduln e e ngjeshmërisë 50M/N/m <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	130.00	661.02	118.98	6.00	780.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe shtrija e zhavorit (fraksion Ø-31mm) duke e bërë shtrijen dhe planifikim e tij sipas nivelitës së kërkuar deri në moduln e e ngjeshmërisë 70M/N/m <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	66.00	335.59	60.41	6.00	396.00 €



4	Furnizimi, transporti, dhe montimi i skajorëve të betonit me dimensione 18 x 24 cm. (Ilogaricet për punë plotësisht të përfunduar, qëmimi i dheut për skajorë, përgaditja e betonit, vuarja në vepër e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i skajorit, dth. duhet të llogaricet për punë plotësisht të përfunduar)	m <sup>1</sup>	208.00	705.08	126.92	4.00	832.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i rigolave nga betoni me dim. 30x30x10 cm. (Ilogaricet për punë plotësisht të përfunduar, qëmimi i dheut për rigollë, përgaditja e betonit, vuarja në vepër e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i rigollit, dth. duhet të llogaricet për punë plotësisht të përfunduar)	m <sup>1</sup>	85.00	360.17	64.83	5.00	425.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe shtrirja mbi zhavorrin e ngjeshur me gurin e bluar 4-8 mm me trashësi l=5cm, për vendosjen e kubzave, duke bërë shpërndarjen e tij me njëjtë adekuarë me tuba të molalit, për tu realizuar niveletat e kërkuar	m <sup>3</sup>	30.00	203.39	36.61	8.00	240.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubzave të parafabrikuara nga betoni C-30 në formë "dupëll T" ose modeli tulle (sipas përzgjedhjes së Menaxherit të Kontrates), me trashësi 8cm, për punimin e rrugës. (Ilogaricet për punë plotësisht të përfunduar me të gjitha procedurat përcjeltase për këtë lloj të punëve, barfja me piranier, ngarkimi, shkarkimi, etj.).	m <sup>2</sup>	615.00	3648.31	656.70	7.00	4,305.00 €
<b>TOTALI MBISTRUKTURA:</b>							<b>6,985.00 €</b>

<b>REKAPITULIM</b>						
1	<b>PUNËT PËRGADITORE</b>					80.00
2	<b>PUNËT E DHEUT</b>					390.00
3	<b>OBJEKTET</b>					620.00
4	<b>MBISTRUKTURA</b>					6985.00
<b>TOTALI:</b>						<b>8,075.00 €</b>



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RREGULLIMIT TË RRUGËS MEHDI HAJREDINI**

Nr.	Pershkrimi i punes	Njesia	Sasia				Cmimi Njesi	Totali
<b>PUNËT PËRGADITORE</b>								
1	Inqizimi gjedezik para fillimit të punimeve, gjatë ekzekutimit të punëve si dhe pas përfundimit të punëve, ku të gjitha sasitë duhet të vërtetohen me majte gjedezike, sipas kërkesës së organit mbllyqës.	m'	130.00	11.02	1.98	0.10	13.00 €	
2	Demoimi i betonit në pjesën ku do të punohet rruga dhe në pjesët ku nevojitet preciza e betonit atër mureve ogzistuese, ku në tërë sipërfaqën që duhet demouar duhet të punohet edhe me dorë në pjesë ku me makine nuk është e mundur. (në çmim përfshihen të gjitha pajisjet që përdoren për këtë lloj të punimeve për demoim, siq janë makineria, kompresori, hilti dhe të ngjashme)	m <sup>2</sup>	46.00	3.90	0.70	0.10	4.60 €	
3	Shqyrtimi i të gjitha provave (atestet) per te gjitha shtruesat e rruges ne laborator sipas kerkeses se investitorit (Nehbazes, shtruses, stabilizueses, Tampon 0-63, Tamponi 0-30, kubezave te betonit etj..)	copë	4.00	67.80	12.20	20.00	80.00 €	
<b>TOTALI PUNËT PËRGADITORE:</b>								<b>97.60 €</b>
<b>PUNËT E DHEUT</b>								
1	Çermetimi i dheut i kategorisë së II-VI-të me ngarkim dhe hartie deri në depomi në largësi min. 10km. Në vëllim është përfshirë edhe punimi dhe formësimi i kanaleve kulluese të rrugës. Po ashtu në llogari hyn edhe betoni dhe asfalti i cili është i demtuar te largohet	m <sup>2</sup>	148.20	125.59	22.61	1.00	148.20 €	
2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me vibratorinder deri në 30 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	481.00	122.29	22.01	0.30	144.30 €	
<b>TOTALI PUNËT E DHEUT:</b>								<b>292.50 €</b>

<b>OBJEKTET</b>									
1	Ngritja e pusctave me beton të armuar duke bërë shabllon unik për çdo pusctë dhe ngritja e pusctës duhet të bëhet në mënyrë precize dhe të jetë në nivelin me këmbëza	copë	5.00	84.75	15.25	20.00	100.00 €		
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të Pusctës duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i gëzës mbi 45Ton.	copë	5.00	338.98	61.02	80.00	400.00 €		
3	Punimi i pusctave të reja, Përfshirë furnizimin me gypa të betonit (Ø800mm së bashku me konus, si dhe kapakim e materiali gëzë me peshë bartëse mbi 45Ton.	copë	1.00	84.75	15.25	100.00	100.00 €		
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të ujembledhësit (grilave) me dimensione 40x40 cm. i cili duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i gëzës mbi 45Ton, përfshirë gypin për pusctë dhe gypin deri te puscta e kanalizimit atmosferik dhe stases.	copë	3.00	152.54	27.46	60.00	180.00 €		
<b>TOTALI OBJEKTET:</b>							<b>780.00 €</b>		
<b>MBISTRUKTURA</b>									
1	Demolimi i skajoreve egzistues për kyqe në rrugë, me ngratim dhe transport të skajoreve të demoluar deri në depot të përcaktuar nga organi mbikëqyrës.	m <sup>3</sup>	5.00	4.24	0.76	1.00	5.00 €		
2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-60mm)duke e bërë shtrirjen dhe planifikim e tij sipas niveletës së kërkuar deri në moduln e e ngjeshmërisë 50MN/m <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	96.20	489.15	88.05	6.00	577.20 €		
3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31mm) duke e bërë shtrirjen dhe planifikim e tij sipas niveletës së kërkuar deri në moduln e e ngjeshmërisë 70MN/m <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	52.91	269.03	48.43	6.00	317.46 €		
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajoreve të betonit me dimensione 10 x 20 cm. (llogaritë për punë plotësisht të përfunduar, gërmimi i dheut për skajorë, pregaditja e betonit, vuarja në vepër e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i skajorit, dith duhet të llogaritë për punë plotësisht të përfunduar)	m <sup>3</sup>	90.00	228.81	41.19	3.00	270.00 €		
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i rigolave nga betoni me dim. 30x30x10 cm. (llogaritë për punë plotësisht të përfunduar, gërmimi i dheut për rigollë, pregaditja e betonit, vuarja në vepër e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i rigollës, dith duhet të llogaritë për punë plotësisht të përfunduar)	m <sup>3</sup>	115.00	487.29	87.71	5.00	575.00 €		

6	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e ngjeshur me gurin e bluar 4-8 mm me trashësi (±5cm, për vendosjen e kubzave, duke bërë shpërndarjen e tij me një cilësi adekuate me tuba të metalit, për ta realizuar niveletat e kërkuar.	m <sup>3</sup>	24.05	163.05	29.35	8.00	192.40 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubzave të paratrabikuara nga betoni C-30 në formë "dupell T" ose modeli tulle (sipas përzgjedhjes së Menaxherit të Kontraktës), me trashësi 8cm, për punimin e rrugës (Ilogaritet për punë plotësisht të përfunduar me të gjitha procedurat përcjellose për këtë lloj të punëve, hartëja me pritimet ngarkimi, shkarkimi, etj.).	m <sup>2</sup>	490.00	2906.78	523.22	7.00	3,430.00 €
<b>TOTALI MBISTRUKTURA:</b>							<b>5,367.06 €</b>

<b>REKAPITULIM</b>							
1	<b>PUNËT PËRGADITORE</b>						97.60
2	<b>PUNËT E DHEUT</b>						292.50
3	<b>OBJEKTET</b>						780.00
4	<b>MBISTRUKTURA</b>						5367.06
<b>TOTALI:</b>							<b>6,537.16 €</b>



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RREGULLIMIT TË RRUGËS ELBASANI**

Nr.	Pershkrimi i punës	Njësia	Sasia			Cmimi Njësia	Totali
<b>PUNËT PËRGADITORE</b>							
1	Ingjizimi gjeodezik para fillimit të punimeve, gjatë caktimit të punëve si dhe pas përfundimit të punëve. Këtu të gjitha sasi të duhet të vërtetohen me matje gjeodezike, sipas kërkesës së organit mbikqyrtës.	m <sup>1</sup>	300.00	25.42	4.58	0.10	30.00 €
2	Shqyrtimi i të gjitha provave (atestet) për të gjitha shtrësat e rrugës në laborator sipas kërkesës së investitorit (Nënbazës, shtrësat stabilizuese, Tampon 0-63, Tamponi 0-30, katezave të betonit etj..)	copë	8.00	135.59	24.41	20.00	160.00 €
				<b>TOTALI PUNËT PËRGADITORE:</b>			<b>190.00 €</b>
<b>PUNËT E DHEUT</b>							
1	Çerçimi i dheut i kategorisë së II-VI-të me ngarkim dhe barje deri në depoti në largësi min. 10km. Në veçim të shtitë përfishitje edhe punimi dhe formësimi i kanalëve kulluese të rrugës.	m <sup>3</sup>	315.00	266.95	48.05	1.00	315.00 €
2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me vibratorliinder deri në 30 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	1260.00	320.34	57.66	0.30	378.00 €
				<b>TOTALI PUNËT E DHEUT:</b>			<b>693.00 €</b>

**OBJEKTET**

1	Ngritja e pusctave me beton të armuar duke bërë shabllon unik për çdo pusctë dhe ngritja e pusctës duhet të bëhet në mënyrë precize dhe të jetë në nivelin me kulçëza.	copë	8.00	135.59	24.41	20.00	160.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të Pusctës duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i gëzës mbi 45Ton	copë	8.00	542.37	97.63	80.00	640.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakut të ujembledhësit (gritave) me dimensione 40x40 cm, i cili duhet të jetë me peshë mbajtëse nga materiali i gëzës mbi 45Ton, përfshirë gypin për pusctë dhe gypin deri te pusctat e kanalizimit atmosferik ekzistues.	copë	7.00	355.93	64.07	60.00	420.00 €
<b>TOTALI OBJEKTET:</b>							<b>1,220.00 €</b>

**MBISTRUKTURA**

1	Demolimi i skajorëve egzistues për kyqe në rrugë, me ngarkim dhe transport të skajorëve të demoluar deri në depot të përcaktuar nga organi mbikëqytës.	m <sup>3</sup>	6.00	5.08	0.92	1.00	6.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-60mm) duke e bërë shtrirjen dhe planifikim e tij sipas niveletës së kërkuar deri në modulin e e ngjeshmërisë 50MN/m <sup>2</sup>	m <sup>3</sup>	240.00	1220.34	219.66	6.00	1,440.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion Ø 0-31mm) duke e bërë shtrirjen dhe planifikim e tij sipas niveletës së kërkuar deri në modulin e e ngjeshmërisë 70MN/m <sup>2</sup>	m <sup>3</sup>	120.00	610.17	109.83	6.00	720.00 €
4	Furnizimi, transporti, dhe montimi i skajorëve të betonit me dimensione 10 x 20 cm. (Ilogaritet për punë plotësisht të përfunduar, gërmimi i dheut për skajorë, përcaktimi e betonit, vuarja në veprat e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i skajorit, ditë, duhet të llogaritet për punë plotësisht të përfunduar)	m <sup>3</sup>	600.00	1525.42	274.58	3.00	1,800.00 €

5	Furnizimi, transporti dhe montimi i rregolave nga betoni me dim. 30x30x10 cm. (Ilogaritjet për punë plotësisht të përfunduar, gjërat e dhëna për rigollitë, përgaditja e betonit, vartja në veprë e betonit, e deri te vendosja dhe montimi i rigollit, d.th. duhet të llogaritet për punë plotësisht të përfunduar).	m <sup>3</sup>	280.00	1186.44	213.56	5.00	1.400.00 €
